



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot. Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2016  
Nr. Dok. 201602212/5

**Lënda :** *Rekomandim për zgjidhjen konform akteve normative në fuqi të rastit të bllokimit të armës së gjahut shtetasit K.G.*

**Drejtuar :** Drejtorit të Drejtorisë Vendore të Policisë  
Z. Neritan NALLBATI

Fier

*I nderuar zoti Nallbati,*

Sikurse ju kemi vënë në dijeni, në Institucionin e Avokatit të Popullit ka bërë ankesë shtetësja Z.G., me banim në fshatin Lalar, Njësia Administrative Portës, Fier. Ankuesja shkruan se në datën 17.12.2014, punonjësi i policisë së zonës Rrapush Hasaj i ka marrë armën e gjahut, e cila ishte me leje lëshuar në emër të babait të saj, K.G.. Sipas ankueses, punonjësi i policisë këtë veprim e ka kryer kur në banesë ishte vetëm nëna e saj. Bllokimi i armës është bërë në kundërshtim me ligjin pa patur asnjë shkak ligjor dhe nuk ka mbajtur e lënë as procesverbal. Gjithashtu ajo pretendon se ka dy vjet që i bën kërkesë Komisarariatit të Policisë Patos dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Fier.

Ndërkohë për këtë problem ankuesja i është drejtuar me ankesë edhe Ministrisë të Punëve të Brendshme. Drejtoria e Inspektimit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme me shkresën nr. Z-41/1 Prot., datë 19.09.2016 jua ka dërguar juve për trajtim letrën e saj, por nuk i është zgjidhur problemi.

Në bazë të kërkesës tonë, ju me shkresën nr. 96/1, datë 16.12.2016, ndërmjet të tjerave na informuat se, në datën 24.03.2015, shtetasi N.Ç. ka dhënë kallëzim në lidhje me një konflikt pronësie me shtetasit B.Ç. dhe K. G. (babai i shtetasit Z.G.), pasi në vendin e quajtur "Fusha e Jonuzit", në fshatin Lalar, i ishte zënë me forcë parcela e tokës me sip. 5.5 dy nga shtetasit e lartpërmendur.

Në lidhje me këtë problem ka shkuar Zyra e Përmbarimit Fier së bashku me punonjësit e Komunës Portëz dhe kanë caktuar kufinj të, por shtetasi K.G. nuk ka pranuar dhe e ka zaptuar përsëri tokën në fjalë, duke moslënë pronarin

e ligjshëm të shkonte në tokën e tij dhe ndërkohë i ka thënë se do ta vriste nëse shkelte tokën që ishte në konflikt.

Për sa më sipër, me qëllim parandalimin e një krimi më të rëndë, në datën 27.03.2015, është bërë bllokimi i përkohshëm i armës së gjahut në pronësi të shtetasit K.G., duke e çuar atë në magazinën e DVP Fier.

Materialet procedurale për këtë ngjarje i janë referuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier për veprën penale "Pushtim toke", parashikuar nga neni 200 i Kodit Penal në ngarkim të shtetasve B.Ç. dhe K.G..

Në datën 23.07.2015, shtetasi A.Ç. ka dhënë kallëzim për një konflikt pronësie me shtetasit B.Ç. dhe K.G., pasi në vendin e quajtur "Fusha e Jonuzit", në fshatin Lalar, i ishte zënë me forcë parcela e tokës me sip. 5.5 dy nga shtetasit e lartpërmendur.

Në lidhje me këtë problem në datën 27.11.2015 ka shkuar Zyra e Përmbarrimit Fier, e cila ka bërë ekzekutimin e Urdhrit në 1618, datë 31.10.2014. Edhe pas ekzekutimit të këtij urdhri, shtetasit B.Ç. dhe K.G. e kanë mbajtur tokën me forcë dhe e kanë mbjellë me misër.

Gjatë zbatimit të vendimit nga Zyra e Përmbarrimit Fier ka pasur dhunë fizike ndërmjet palëve në konflikt dhe ky ishte motivi për të cilin iu bllokua arma e gjahut shtetasit K.G..

Materialet procedurale për këtë ngjarje i janë referuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier për veprën penale "Pushtim toke", parashikuar nga neni 200 i Kodit Penal në ngarkim të shtetasve B.Ç. dhe K.G..

Gjithashtu ju na informuat se është marrë kontakt me shtetasit N. dhe A.Ç. dhe jeni informuar se konflikti i tyre me shtetasin K.G. vazhdon të jetë i acaruar.

Nga shqyrtimi i kësaj ankesë dhe i përgjigjes së dërguar nga ana juaj arrijmë në konkluzionin se, bllokimi i armës së gjahut shtetasit K.G. është bërë nga punonjësi i policisë të organit tuaj në datën 27.03.2015. Mbajtja në gjëndje bllokimi i kësaj arme gjahu për një kohë prej më shumë se një vit e nëntë muaj është veprim i paligjshëm dhe vjen në kundërshtim me nenin 121/3 të ligjit nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit", sipas të cilit afati maksimal i bllokimit të sendeve është 30 ditë. Ndërkohë ju bëjmë me dije se, bllokimi i armës së gjahut për një kohë kaq të gjatë, sikurse ka ndodhur në këtë rast, nuk parashikohet as në dispozitat e ligjit nr. 74/2014 "Për armët", si dhe në aktet nënligjore që kanë dalë në bazë dhe për zbatimin e tyre.

Ky veprim i policisë ka sjellë shkeljen e të drejtës ligjore të ankuesit për të poseduar e gëzuar lirisht pronën e tij të ligjshme (armën e gjahut) të garantuar nga dispozitat e Kodit Civil. Nëse shtetasi K.G. ka shkelur kriteret ligjore për mbajtjen e armës së gjahut, nga komisioni përkatës duhet të veprohej konform dispozitave ligjore në fuqi, duke ia hequr atij lejen e dhënë për të mbajtur armën e gjahut dhe bërë shitjen e kësaj arme duke zbatuar procedurat përkatëse.

Ndërkohë në përgjigjen e dërguar nuk na informoni lidhur me pretendimin e ankueses se, nga punonjësi i policisë që ka bërë bllokimin e armës së gjahut nuk është mbajtur e dhënë poseduesit kopja e procesverbalit përkatës. Mosdhënia e informacionit lidhur me këtë pretendim dhe mosdërgimi i kopjes së procesverbalit në fjalë, provon se pretendimi i ankueses është i drejtë.

Për sa më sipër dhe me qëllim parandalimin e rasteve të tilla në të ardhmen, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe në gërmën “b” të nenit 21 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

## **REKOMANDOJMË**

1. Marrjen e masave të nevojshme për zgjidhjen përfundimtare dhe konform dispozitave të akteve normative në fuqi të problemit të bllokimit të armës së gjahut shtetasit K.G..

2. Zbatimin me korrektesë nga punonjësit e policisë të detyrimeve që rrjedhin nga neni 121 i ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, lidhur me rastet dhe afatet kohore të bllokimit të sendeve qytetarëve të ndryshëm, si dhe për hartimin e procesverbalit të bllokimit të sendeve dhe dhënien e kopjes poseduesve të tyre.

3. Marrjen e masave të nevojshme për përgjithësimin e këtij rasti në efektivin e Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan, pavarësisht faktit që ai ka ndodhur para më shumë se një vit e nëntë muaj, me qëllim që raste të tilla të mospërsëriten më në të ardhmen në organet që janë në varësinë tuaj.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi të na ktheni përgjigje brenda afatit ligjor prej 30 ditësh të parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**K O M I S I O N E R I**

**Arben SHKËMBI**